



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS

Nr. 554 / Prot.  
15

Patos më, 05/04/2024

Miratohet  
Kryetari  
Faton Duro

PROJEKT-VENDIM

Nr. 31, datë 05.04.2024

**MBI MIRATIMIN E SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT PUBLIK TË LINJËS  
PATOS I RI-MUSTAFA MATOHITI-MARGËLLIÇ ME MJETE TRANSPORTI TË  
BASHKISË, MITATIMIN E VLERËS SË BILETËS SI TARIFË PËR MBULIMIN  
E SHËRBIMIT ME MJETE TRANSPORTI**

Në zbatim të nenit 32 pika 2, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të nenit 14 pika 3, ligjit 68/2017 datë, 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të nenit 10 shkronja c, ligjit 8308 datë, 18.03.1998 me ndryshimin e fundit me nr.10/2016 datë 11.02.2016 "Për Transportin rrugor", Rezultateve të konsultimit publik nr.554/4 datë 02.04.2024, GMS pasi ka analizuar gjithë procesin e ndjekur për këtë situatë paraqet në Këshillin Bashkiak projekt Vendimin dhe,

KËRKON:

1. Të miratohet shërbimi i transportit publik për linjën Patos i Ri-Mustafa Matohiti-Margëlliç me mjete transporti nga Bashkia.
2. Te mitarohet tarifën e biletës prej 50 lekë.
3. Të vendosë dhe të miratojë oraret e transportit për cdo ditë.

**GRUPI I MENAXHIMIT**

Sokol Meta

Ina Sauli

Mimoza Shtëmbari

Arben Semanjaku

Elda Goxhaj

Juela Shpata

Astrit Murati

Gazmira Pleasati

Adresa: bagja "Nafiëtari", Rruga "Onaza", Patos

Eriom **Hatia**  



Orges **Golloshi**  


Alket **HALIMI**  


Eneo **Xhaferi**  


Arben **Shpërdheja**  


Endrit **Cako**  


Armando **Gushi**  


Florian **Kita**  


Blerina **LAÇI**  


Barie **Goxhaj**  


Nurke **Hazizaj**  


Lindita **Pepa**  


Adm. Njësia Administrative Zharrëz

Adm. Njësia Administrative Ruzhdije

Riza **Hoxha**



Agim **Mesutaj**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E PATOS

Nr. 554 / Prot.  
6

Patos, më 05/04 /2024

**RELACION SHPJEGUES PËR MIRATIMIN E SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT PUBLIK TË LINJËS “ PATOS I RI- MUSTAFA MATOHITI- MARGËLLIÇ” ME MJETET E TRANSPORTIT TË BASHKISË DHE MIRATIMIN E TARIFËS PËR SHËRBIMIN**

Kjo kërkesë për miratimin e shërbimit të transportit publik të linjës “Patos i Ri – Mustafa Matohiti – Margëlliç” me mjetet e transportit të bashkisë dhe miratimin e tarifës së shërbimit vjen bazuar në ligjin nr. 10/2016, datë 11.02.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore” si dhe kërkesës së qytetarëve për vendosjen e linjës së transportit publik.

Qytetarët e prekur nga mungesa e shërbimit të transportit publik kanë drejtuar kërkesën për vendosjen e linjës së transportit publik pranë bashkisë Patos me shkresën nr. 554 prot., datë 26.02.2024. Qytetarët kanë kërkuar marrjen e masave për zgjidhjen sa më të shpejtë të problemit pasi nuk kanë transport publik prej gati 4 muaj duke sjell vështirësi edhe në marrjen e shërbimeve të tjera, ku më kryesori është shërbimi shëndetësor. Bashkëngjitur kërkesës është edhe lista e firmosur nga banorët e prekur nga mungesa e shërbimit të transportit publik, në total 274 banorë.

Për të ofruar shërbimin e transportit publik për linjën “Patos i ri – Mustafa Matohiti - Margëlliç” Këshilli i Bashkisë së bashku me ekzekutivin ka realizuar dëgjese publike me temë Vendosje të linjës së transportit publik “ Patos i Ri – Mustafa Matohiti – Margëlliç” me përfaqësues të kryetarëve të fshatrave, banorët e lagjeve dhe fshatrave të prekur nga mungesa e linjës së transportit publik. Për sa më sipër dhe duke marr parasysh faktin që nuk është arritur një marrëveshje ndërmjet bashkisë dhe subjekteve që ofrojnë shërbimin e transportit publik bashkia do të ofrojë shërbimin e transportit publik për linjën “Patos i ri – Mustafa Matohiti - Margëlliç” me mjetet e veta.

Bileta do të jetë 50 lekë, tarifë kjo e nevojshme për mbulimin e kostove të karburantit dhe shërbimit të mirëmbajtjes së automjeteve që do të përdoren për linjën “Patos i ri – Mustafa Matohiti - Margëlliç”. Numri i orareve të mjeteve do të përcaktohet nga Këshilli i Bashkisë.


Për sa më sipër ftojmë Këshillin e Bashkisë që të miratojë;

Adresa: Lagjja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos



1. Shërbimin e transportit publik për linjën Patos i Ri-Mustafa Matohiti-Margëlliç me mjete transporti nga Bashkia.
2. Tarifën e biletës prej 50 lekë.
3. Të vendosë dhe të miratojë oraret e transportit për cdo ditë.

**Koodrinatori i GMS**  
Ina Sauti



**Sekretar i GMS**  
Mimoza Shtëmbari



*20. Kryetari  
Dr. Haxhiu  
Sek. Juhri  
Je projektet  
që konsultohen  
me bashkinë  
në mënyrë  
publike  
në bashkëpunim  
me Komitetin  
publik*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 554/Prot.  
4

Patos, më 02.04.2024

**Lënda:** Rezultatet e konsultimeve publike të prioriteteve të Komunitetit të Bashkisë Patos.

**Drejtuar:** Kryetarit të Bashkisë Patos.

Këshilli i Bashkisë pasi shqyrtoi dhe analizoi rezultatet e dëgjësës publike me temë **Vendosje të linjës së transportit publik “Patos i ri -Muatafa Matohiti - Margëlliç”** kërkon reflektimin e prioritetit kryesorë që ka dalë nga kjo dëgjësë. Dëgjësë e cila u realizua në bazë të kërkesës së banorëve për zonat: “Margëlliç”, “Rerës”, “Dukas Breg”, “Mustafa Matohiti”, me nr. 554 datë 26.02.2024.

Këshilli i Bashkisë së bashku me ekzekutivin ka realizuar takim konsultativ në ambjentet e shkollës “Mustafa Matohiti” me përfaqësues të Kryetarëve të fshatërave, banorët e lagjeve dhe fashtarve, të cilët kanë dhënë opinionet e tyre lidhur mbi temën e dëgjësës për ofrimin e shërbimit të transportit rrugor në zonat e tyre të banimit. Këshilli i Bashkisë pasi analizoi rezultatet e dëgjësës publike vëren se kërkesat prioritare të banorëve vendas janë:

1. Vendosje të linjës së transportit publik “Patos i ri -Muatafa Matohiti - Margëlliç”.
2. Demtimi i rrugës së lagjes “Rrapushaj”.
3. Mungesa e mjekut dhe planifikimi i ofrimit të kujdesit shëndetësor.
4. Shtrimin e rrugëve të lagjeve.

Përsa më sipër, rekomandojmë që Bashkia të marrë parasysh kërkesat e paraqitura gjatë dëgjësës publike si dhe të reflektojë rekomandimet e komunitetit.



KRYETAR

Armand Ahmetaj

Adresa: Lagja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos